



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës (KS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Keqklasifikimi i shpenzimeve në shumën 210,051€ si pasojë e mos regjistrimit të duhur të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike përkatëse.
- A2 Mbivlerësimi i prezantimit/shpalosjes së detyrimeve kontigjente për 66,685€.
- B1 Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale dhe jo kapitale në regjistrin e përgjithshëm të pasurive. Si pasojë janë nënvlerësuar pasuritë kapitale për 964,912€, ndërsa pasuritë jokapitale për 253,820€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Suharekës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Mos hartimi i projekteve ekzekutiv për projektet kapitale.
- A4 Komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 1,058,033€ apo 2,010 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor sipas nenit 39.1 të Ligjit Nr. 03/L-048 për MFPP.
- A5 Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve.
- A6 Mos marrja e pëlqimit paraprak për projektin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kontraktimi i shërbimit të përfshir në kontratën e AQP-së.
- A7 Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit.
- B2 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Suharekës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Suharekës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Suharekës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Procesi i raportimit në Komunë është përcjellur me mangësi, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Më tutje, pasqyrat financiare janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA, përveç çështjeve të trajtuara më poshtë të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit. Në mungesë të kontrolleve të brendshme të duhura në Komunë, janë identifikuar disa çështje të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit dhe konkluzioni i pajtueshmërisë. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe tre (3) janë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike

Gjetja

Neni 18, paragrafi 3, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Bazuar në testet e kryera rezulton se kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim:

- Shpenzimet për softuer, fotokopje dhe tavolina, në shumën 25,000€, ishin regjistruar në kategorinë mallra & shërbime në vend që të klasifikohen në kategorinë e investimeve kapitale;
- Shpenzimet për projektin “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve nga bora”, në shumën 65,000€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek mallra & shërbime;
- Shpenzimet për projektin “Ndërtimi i serave për fermerë”, në shumën 61,780€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në kodin ekonomik investime në vijim, në vend që të klasifikohen tek subvencione & transfere; dhe
- Shpenzimet për projektin “Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti të fermerëve”, në shumën 58,271€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në kodin ekonomik investime në vijim, në vend që të klasifikohen tek subvencione & transfere.

Keqklasifikimet kishin ndodhur për shkak se këto shpenzime ishin

planifikuar dhe buxhetuar gabimisht.

Ndikimi Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyra financiare, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/ kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Prezantimi/shpalosja jo e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV

Gjetja Sipas Rregullores MF nr. 01/2017, Neni 3 1.1. Detyrim kontingjent - është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen; dhe Neni 18 Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Në raportin vjetor financiar ishin shpalosur detyrime kontingjente në shumë 509,356€, mirëpo kjo shumë është e pasaktë për shkak të përfshirjes edhe të dy rasteve të përfunduara (22,560€ dhe 44,125€), që rezulton me mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 66,685€.

Përfshirja e detyrimeve që janë të ekzekutuara tek shpalosja e detyrimeve kontingjente ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente dhe nga pamjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm.

Ndikimi Mos prezantimi i plotë i detyrimeve kontingjente (eventualiteteve), shkakton mbivlerësim/ nënvlerësim të tyre, dhe për pasojë mund të ketë implikime buxhetore për mbulimin e detyrimeve financiare në vitin pasues, në rast të humbjes së këtyre kontesteve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencat të sakta për detyrimet kontingjente në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Dobësitë në regjistrimin e pasurive

- Gjetja** Neni 6 i rregullës MF nr.01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB përcakton që - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.
- Pasuritë kapitale jo financiare të blera gjatë vitit 2021, ishin në shumën 4,952,209€, ndërsa në regjistrin e përgjithshëm të pasurive kapitale ishin regjistruar 3,987,296€ me një diferencë prej 964,912€.
- Përveç kësaj, shuma e pasurive nën 1,000€ të shpalosur në pasqyra financiare ishte 2,471,025€, ndërsa në regjistrin e përgjithshëm të pasurive në vlerën 2,7124,845€, duke u nëvlerësuar ato për 253,820€.
- Mos regjistrimi i plotë i pasurive kishte ardhur si pasojë që zyrtari i caktuar për pasuri (pas pensionimit të zyrtarit të pasurive, më 24 dhjetor 2021) nuk i'u kishte dhënë qasja në Sistem nga Thesari, deri në kohën e kryerjes së auditimit më 10 maj 2022.
- Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton menaxhim të dobët të pasurisë, si pasojë ndikon në mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe në prezantimin jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se, të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë kapitale dhe jo kapitale duke pasur parasysh edhe përlogaritjen e zhvlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Mos hartimi i projekteve ekzekutiv për projektet kapitale

Gjetja Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, në nenin 20.10 parasheh që, specifikat teknike për kontratën e punës duhet të përfshijnë një projekt ekzekutiv si pjesë substanciale të veten.

Për projektet si më poshtë nuk ishte zbatuar kërkesa ligjore që, për secilën kontratë të punës duhet të hartohet një projekt ekzekutiv (për këto projekte ishin përgaditur vetëm paramasat dhe paralogaritë):

- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale: Bubulina; Xhavit Kelmendi; Milaim Bugari; Shaban Polluzha dhe rrugë tjera lokale Suharekë”, në vlerë prej 137,399€;
- Projekti “Rregullimi dhe sanimi i rrugëve lokale”, në vlerë prej 96,811€;
- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale në lagjen Boka - vazhdim; ndërtimi i rrugës në lagjen Qarri - Esat Qarri - Grajqevc”, në vlerë prej 26,301€.

Sipas zyrtarëve përkatës, me qëllim të mos vonesës së procedurave të prokurimit nuk ishin hartuar projektet ekzekutive.

Ndikimi Kryerja e procedurave të prokurimit, pa një projekt ekzekutiv të hartuar paraprakisht, mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këtë projekt të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që, hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Mos pagesa e faturave brenda afatit 30 ditë

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve (lista e marrë), kemi vërejtur se gjatë vitit 2021, ishin kryer pagesa në shumën 1,058,033€ apo 2,010 raste të pagesave ndaj furnitorëve, të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor, që kanë rezultuar edhe me pagesa përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e Komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, Komuna mund të jetë subjekti i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbarimore.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që, obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja Sipas nenit 20 pika 3.1 të Rregullores MF nr. 04/2017 - Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve parashihet që, aplikuesit të ofrojnë dëshmi se kanë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet pensionale sipas legjislacionit në fuqi; ose në rast të ekzistencës së detyrimeve, aplikuesit të ofrojnë një marrëveshje me autoritetet tatimore për përmbushjen e detyrimeve të tilla.

Bazuar në testet e kryera rezulton se, katër OJQ ⁴ fituese të subvencioneve janë përzgjedhur pa i plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara si: dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore dhe pensionale ndaj Administratës Tatimore. Shuma vjetore e këtyre katër përfituesve të subvencioneve në total ishte 20,500€.

Kjo ka ndodhur nga neglizhenca e komisionit të vlerësimit të cilët nuk kanë marrë parasysh kërkesat e rregullores me rastin e vlerësimit dhe ndarjes së subvencioneve dhe transfereve.

Ndikimi Përzgjedhja e përfituesve nga Komisioni vlerësues, pa u përmbushur kriteret e parapara në thirrjen publike, paraqet dëmtim të buxhetit dhe jo transparencë publike.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që, Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të subvencioneve të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore dhe pensionale ndaj Administratës Tatimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mos marrja e pëlqimit paraprak për projektin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kontraktimi i shërbimit të përfshirë në kontratën e AQP-së

Gjetja Rregullorja nr. 06/2018 - Për menaxhimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në nenin 6.3 parasheh që, për inicimin e projektit insitucionet marrin pëlqim paraprak nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Përveç kësaj, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) kishte një kontratë të nënshkruar për "Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera - Niveli lokal - Lot III".

Komuna kishte lidhur kontratë për "Blerjen e softuerit për menaxhimin e

performancës dhe softuerit për digjitalizimit të arkivës”, në vlerë 44,250€, pa marrjen e pëlqimit paraprak nga ASHI.

Përveç kësaj, kjo kontratë përfshinë edhe shërbimin e skanimit me çmim 0.04€/ për faqe, ndërsa sipas Kontratës së AQP-së, shërbimi i skenimit ishte i kontraktuar me çmimin 0.0061€/ për faqe. Duke analizuar dhe krahasuar numrin e faqeve për skanim të kontraktuar prej Komunës, për 556,125 faqe ishte 22,245€, ndërsa sipas kontratës së AQP-së një shërbim i tillë në vlerë financiare do të ishte 3,392€, ku do të realizohej një kursim prej 18,852€.

Sipas zyrtarëve të Komunës, kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së njohurisë për kerkesat të tilla.

Ndikimi Kontraktimi i një shërbimi që është i kontraktuar nga AQP-ja dhe mungesa e marrjes së pëlqimit nga ASHI-ja, ndikojnë në përdorimin jo të duhur apo keqpërdorim të parasë publike.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që, para investimeve në teknologjinë e informacionit të marrë pëlqimin nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, si dhe në rastet e kontratës aktive të Agjencisë Qendrore të Prokurimit për shërbime për nivelin lokal ta zbatoj atë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit

Gjetja Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 32.1, për një aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Nëse një dispozitë e neneve 34-37 të këtij ligji shprehimisht autorizon shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji.

Kontrata "Inventarizimi i Shtepisë Muze Fadil Vata në Sallagrazhdë", me vlerë 21,999€, është kontraktuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me ftesë të tre operatoreve ekonomik duke u thirrur në nenin 35 paragrafin 2.1 të LPP-së, ndërsa do të duhej të realizohej përmes procesit të rregullt të prokurimit me procedurë të hapur.

Sipas zyrtarëve të Komunës kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së planifikimit të aktivitetit të prokurimit.

Ndikimi Përdorimi i procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë, lë hapsirë të kufizimit të konkurrencës në rastet kur furnizimin mund ta ofertojnë shumë operator ekonomik.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë që, inicimi i aktiviteteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë**Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Për 2,382 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - “Zbritjet për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezultojn më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 53,595€.

Përveç kësaj, zbritja primare ishte zbatuar ndaj 213 tatimpaguesve, të cilët kanë në posedim prona rezidenciale më shumë se një pronë, zbritje e cila rezultojn më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 4,792€.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar “Banimin Parësor” nuk do të zbatohet zbritja e lejuar.

Ndikimi

Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, rezultojn me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi B2

Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të arkëtueshmet

Llogaritë e Arkëtueshme (LLA) janë prezantuar në PFV në vlerë prej 5,880,526€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, tatimi në tokë, taksa e biznesit, shfrytëzimi i pronës publike etj

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve

Gjetja	<p>Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës, në nenin 3.3 përcaktohet që, në rast të vonesës së pagesës së qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet konform kamatave bankare të cilat janë në fuqi.</p> <p>Testet e kryera në lidhje me zbatimin e ndëshkimeve konform kamatave bankare ndaj qiramarrësve, në rast të vonesës së pagesës së qirasë, rezultojnë se në dy raste nuk ishin zbatuar ndëshkimet edhe pse ka pasur vonesa të pagesës së qirasë nga qiramarrësit.</p> <p>Përveç kësaj, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë, qiratë dhe nga taksat në aktivitete të biznesit kanë një trend të rritjes, për të cilat nuk janë ndërmarrë veprimet ligjore për inkasimin e tyre.</p> <p>Sipas zyrtarëve të Komunës, të arkëtueshmet e grumbullura ndër vite (borxhe të vjetra), si dhe gjendja financiare e bizneseve dhe qytetarëve për t'i realizuar obligimet ndaj Komunës, ishte një ndër shkaqet kryesore për mbledhjen e të arkëtueshmeve.</p>
Ndikimi	Rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve ndikon në realizimin e projekteve të cilat do të financoheshin nga të hyrat vetanake.
Rekomandimi B3	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e të arkëtueshmeve dhe të zbatojë mekanizmat ligjor të mbledhjes së tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2021, ishte 85,783€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2022.

Çështja A8 - Pranimi i faturave, pa raport të pranimit për shërbimin e kryer

- Gjetja** Rregulla financiare nr. 01/2013 për Shpenzimin e parave publike, në nenin 24 për pranimin dhe pagesën e faturës, ndër të tjera parasheh që të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit si: të siguruarit e raportit të pranimit të mallit/ shërbimit nga zyrtari/ komisioni i autorizuar.
- Për projektet “Lot 1 - Projektet për parandalimin e vërshimeve në Suharekë dhe Lot 2 - Varrezat e qytetit” dhe “Trajtimi i qenëve endacak” ishin pranuar faturat të listuara në listën e obligimeve, me shumat përkatëse 20,200€ dhe 2,508€, pa u siguruar paraprakisht raporti i pranimit të shërbimit (situacionit) nga të autorizuarit.
- Sipas Komunës, pranimi i faturave pa siguruar paraprakisht raport të pranimit të shërbimit (situacionit) nga të autorizuarit është bërë si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme.
- Ndikimi** Pranimi i faturave pa siguruar paraprakisht raportet e pranimit (situacionet), len hapësirë të pagesave të atyre faturave dhe të keqpërdorimit të parasë publike.
- Rekomandimi A8** Kryetari duhet të sigurojë që, mos të pranohen faturat pa u siguruar paraprakisht raportet e pranimit të mallit/ shërbimit, si dhe të merren veprimet e duhura për faturat e pranuar pa raport pranimi përfshirë mospagesën e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,334,504	17,690,078	16,922,197	16,676,230	15,572,696
Grante Qeveritare - Buxheti	14,521,548	14,778,668	14,568,168	14,891,088	13,656,163
Financimi përmes huamarrjes	0	93,845	93,813	136,680	38,467
Të bartura nga viti i kaluar	0	778,413	623,022	456,636	340,091
Të hyrat vetanake	1,812,956	1,812,956	1,418,764	1,109,380	1,537,975
Donacionet vendore	0	8,340	2,143	3,446	0
Donacionet e jashtme	0	217,856	216,286	79,000	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,355,574€. Kjo rritje është rezultat i rritjes nga granti qeveritar për 257,120€, bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake në vlerë prej 778,413€, donacioneve të brendshme dhe të jashtme në shumë prej 226,196€ si dhe të financimi nga huamarrjet në shumë prej 93,845€.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 16,922,197€, deri sa në vitin paraprak ishte rreth 92%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,334,504	17,690,078	16,922,197	16,676,230	15,572,696
Pagat dhe mëditjet	8,571,766	8,868,913	8,868,913	8,519,757	8,229,756
Mallrat dhe shërbimet	2,096,113	2,284,695	2,160,895	1,633,281	1,468,962
Komunalitë	358,449	388,183	331,882	279,816	273,881
Subvencionet dhe transferet	425,000	616,427	608,298	457,828	298,620
Investimet Kapitale	4,233,900	5,531,860	4,952,209	5,785,548	5,301,477
Rezervat	649,276	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 297,147€ si rezultat i pagesave shtesë për paga dhe mëditje lidhur me menaxhimin e Covid 19 për sektorin e shëndetësisë, arsimit dhe zjarrfikëset;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 188,582€, apo 95% e buxhetit ishte shpenzuar ndërsa komunalit me buxhet final ishin rritur për 29,734 në krahasim me buxhetin fillestar;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 191,427€, përderisa realizimi ishte në masën 99% e buxhetit final;
- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,297,960€. Kjo rritje është rezultat i ri-shpërndarjes së rezervës, të hyrave të bartura nga viti i kaluar, donacioneve dhe burimeve tjera të financimit. Po ashtu, edhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 52% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fundvitit. Gjithashtu, vlen të theksohet se nga 87 projekteve të parapara 60 ishin projekte të reja ndërsa pjesa tjetër ishin të bartura nga viti i kaluar. Buxheti final për këtë kategori ishte shpenzuar 90%.

Si rezultat i situatës pandemike me COVID-19, Komuna e Suharekës kishte shpenzuar 266,809€ për paga dhe mëditje.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 1,863,618€ apo 3% më të larta se plani vjetor. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç kësaj, Komuna kishte edhe të hyra indirekte në shumë prej 323,568€ që kanë të bëjnë me të hyrat nga dënimet në trafik dhe dënimeve nga gjykatat.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,812,956	1,812,956	1,863,618	1,503,448	1,738,348
Të hyrat tatimore	832,746	832,746	968,556	681,365	766,843
Të hyrat jo tatimore	980,210	980,210	895,063	822,082	971,505

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të komunës së Suharekës ka rezultuar në gjashtë rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Përveç kësaj, Raporti i auditimit ishte shqyrtuar edhe në Kuvendin Komunal, në mbledhjen e mbajtur 27 gusht 2021.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tre (3) rekomandime janë zbatuar dhe tre (3) nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se, në bashkëpunim me mirëmbajtësit e softuerit të Pro-tax-it ndërmerren masa në rregullimin e të dhënave në mënyrë që faturimi të jetë i saktë dhe të korrigjohen faturat e lëshuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik tërhiqen apo nuk përgjigjen për të plotësuar kërkesën mbi përshtatshmërinë. Konfiskimi i sigurisë së tenderit për ofertuesit e papërgjegjshëm zvogëlon mundësin e pjesëmarrjes së ofertuesve joserioz.	Në mostrat e testuara nuk kemi hasur terheqje të operatoreve ekonomik, për tu aplikuar konfiskimi i sigurisë së tenderit.	I zbatuar
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është përgatitë plani vjetor i financimit të OJQ-ve, duke ju dhënë prioritet projekteve me rëndësi për publikun e gjerë, njëherit të siguroj që plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohet në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuara me rregullore. Gjithashtu, duhet të formoj komisionet përkatëse për monitorimin e subvencioneve dhe për shqyrtimin e ankesave.	Janë ndërmarr veprime të nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se komisionet e pranimit dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimit të punëve/furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara në përputhje me kontratën.	Janë ndërmarr veprime të nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj përzgjedhjen e anëtarëve kompetent në komisionin e inventarizimit dhe të ndërmerr masa për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e softuerit e-pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të ndodhë me kohë. Të ofrohen trajnime për zyrtarin përkatës i cili do të regjistroj pasurinë jokapitale në softver.	Nuk janë ndërmarr veprime të nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmëve dhe të zbatoj mekanizmat ligjorë të mbledhjes së tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fitim Haliti, Udhëheqës i ekipit



Hysen Boqolli, Anëtar i ekipit



Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike	<p>Pika 3 & 4; Sa i përket Shpenzimet për projektin “Ndërtimi i serave për fermerë”, në shumën 61,780€ dhe “Rregullimi dhe ndërtimi i stallave për bagëti të fermerëve”, në shumën 58,271€. Referuar Udhëzimit administrativ 2005/08 “Transferet kapitale përbëhen nga pagesat e njëanshme të qeverisë, që as nuk krijojnë dhe as shuajnë një obligim financiar, dhe që bëhet me qëllim të mundësimin që pranuesi të përvetësoj pasuri kapitale”. Në anën tjetër në pamundësi për të realizuar projektet në fjalë në kodin përkatës tek kategoria e Subvencioneve & Transfereve si pasojë të kufizimeve buxhetore, pamundësisë së zhvillimit të procedurave të prokurimit. Për të mundësuar realizimin e projekteve në fjalë duke mos afektuar pasqyrat financiare përkatësisht pasurinë jo financiare si zgjedhje optimale ne jemi detyruar që duke shfrytëzuar paragrafin e lartëshënuar, projektet në fjalë t'i klasifikojmë tek transferet kapitale duke u zotuar se të njëjtat pas periudhës së mbulueshmërisë së garancionit do t'i transferoheshin përfituesve të granteve.</p> <p>Fakti se një veprim i tillë (klasifikimi tek kategoria e transfereve kapitale) ka impakt minimal në raportim financiar (ngjashmëri të plotë për nga natyra me kodin e transfereve tek subvencionet), në anën tjetër impakt skajshmërisht negativ që na sjell kualifikimi i opinionit të auditimit për vitin 2021 përmes të cilit ne do të ballafaqohemi me humbje në reputacion por edhe atë financiar.</p>	<p>Bazuar në Udhëzimin administrativ MF-nr. 04/2019 për definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale, përkufizimi i projektit kapital është: një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose përmirësuar asetet; ndërsa përkufizimi i Asetit: një resurs me vlerë ekonomike në pronësi të organizatës buxhetore, që rritë vlerën e pasurisë dhe që pritet të ofrojë përfitime në të ardhmen. Ndërsa, bazuar në Rregulloren MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përkufizimi i pasurisë kapitale përveç tjerave definojnë se: pronësia dhe kontrolli i përfitimeve nga pasuria kapitale, mbetet tek organizata buxhetore. Mbështetur në përkufizimet e përmendur më sipër, shpenzimet për projektet e listura në Çështjen A1: “Ndërtimi i serave për fermerë” dhe “Rregullimi dhe ndërtimi i stallave për bagëti të fermerëve”, nuk janë projekte kapitale sepse kontrolli i përfitimeve nga pasuria kapitale nuk mbetet tek organizata buxhetore, andaj sipas nenit 18, paragrafi 3 i Rregullores Financiare nr 01/2013/ MF, Mbi shpenzimet e parasë publike”, duhet të kenë kodet ekonomike adekuate sipas Udhëzimit Administrativ për planin kontabël.</p>

<p>Prezantimi/shpalosja jo e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV</p>	<p>Vlera 44,125.00 te ky detyrim kontigjent lënda është në proces gjyqësor, në shkallën e parë pranë Gjykatës Themelore në Prizren Dega Suharekë kemi Aktvendimin PP nr.164/19 të Gjykatës me të cilën është Aprovuar Prapsimi i Komunës me datë 21.12.2021 si dhe kjo lënd në muajin maj është dërguar te përmbaruesi privat andaj edhe kjo e dëshmon të kundërtën e kësaj çështje.</p> <p>Aktvendimi është bërë i plotfuqishëm me datë 04.05.2022 si dhe fletëdërgesa personal te përmbaruesi është e datës 11.05.2022 kur është pranuar lënda.</p> <p>Andaj ky detyrim është dashur domosdoshmërisht të paraqitet te detyrimet kontigjente sepse deri në këtë datë nuk kemi mundur të dijm se a do të shkoj lënda në ankesë në Gjykatë të Apelit. (të bashkangjitur keni vendimin e plotëfuqishëm të datës 04.05.2022, fletëdërgesa e datës 11.05.2022).</p>	<p>Sipas Aktevdimit të Gjykatë Themelore Prizren - Dega e Gjykatës në Suharekë, më 21 12.2021, është aprovuar prapsimi i Komunës për Urdhërin Përmbarimor 473/2019, me këshillë juridike që brenda afatit shtatë ditor nga dita e pranimit të vendimitpala a paknaqur ka të drejtë ankesë në Gjykatën e Apelit.</p> <p>Ekipit auditues, nuk i'u dorëzuar dëshmi dhe nuk i'u bërë e ditur deri në përfundim të auditimit, se Përmbaruesi ka bërë Ankesë në Gjykatën e Apelit, andaj shuma 44,125€ e prezantuar si detyrim kontigjent nuk i plotëson kriteret për t'u konsideruar detyrim kontigjent.</p>
<p>Mos hartimi i projekteve ekzekutiv për projektet kapitale</p>	<p>Komuna gjatë shpalljes së procedurave të prokurimit bënë edhe përshkrimin e detajeve që burojnë nga projektet ekzekutive, kjo gjendet në dosje të Tenderit saktësisht tek Specifikimet teknike të Detyrueshme te Aneksi 1 i Dosjes së Tenderit.</p>	<p>Për projektet e listuara tek çështja A3, nuk janë hartuar projektet ekzekutive, si kërkesë e Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, në nenin 20.10.</p>
<p>Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit</p>	<p>Komuna ka udhëhequr procedur të negociuar duke bërë vlerësimin e OE-ve të cilat do të ofrojnë artikuj specifik ku të cilët kanë qenë pjesë e kësaj procedure por pa dashur të kufizojë konkurrencën ka ftuar tre OE për këtë procedurë dhe ku është njoftuar edhe KRPP (bashkangjitur njoftimin).</p>	<p>Artikujt e kontraktuar janë punime druri të cilat nuk mund të konsiderohen artikuj specifik.</p> <p>Për më tepër, vet ftesa e bërë për Operatorët Ekonomik, nënkupton që ky projekt ka mundur të realizohet me procedurë të hapur e jo me procedurë të negociuar.</p>

Leter konfirmim

 <p style="text-align: center;">Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës Republika Kosova - Opstine Suhareka Republic of Kosovo - The Municipality of Suhareka</p> 			
20.06.2022			
LETËR E KONFIRMIMIT 01 01636588 <i>[Signature]</i>			
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve			
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit			
Të nderuar,			
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:			
<ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); • pajtohemme gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, përveç Çështjeve A1; A2; A3; A7 për të cilat kam dërguar komentet; si dhe • brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre. 			
Z. Bali Muharremaj			
Kryetar i Komunës,			
Data: 20.06.2022			

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Katër pagesat në emër të subvencioneve dhe transfereve për entitet publike ishin : pagesa prej 10,000€, pagesa 5,000€, pagesa 3,000€ dhe pagesa prej 2,500€.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.